



Datë: 05.05.2025

Numër protokolli: 3003/2025

A.nr.543/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.543/2025, të datës 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.B., të cilin më autorizim e përfaqëson Avokat Ardiana Azemi nga Prishtina, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 05.05.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.543/2025, e datës 25.03.2025, e parashtruar nga ankuesi M.B.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi me Nr. 002/2025 i datës 21.02.2025, i Komisionit të Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit.

## A r s y e t i m

Ankuesi, M.B. (*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 20.03.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 25.03.2025, kundër Vendimit me Nr. 002/2025 të datës 21.02.2025, të Komisionit për Eksperte në Zyrën e Kryeministrit, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së mundshme në qasje të barabartë në pagë të drejtë dhe zbatim i gabuar i të drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej vetëm Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni i Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit, ndërsa, kjo e fundi, më datë 02.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin së ankesa është e pranueshme në kuptim të nenit 129 të LPPA-së, për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur më këtë çështje ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokolli 1979/2025 të datës 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 14.03.2025; Vendimin me Nr. 002/2025 të datës 21.02.2025, të Komisionit të Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit; Zarin postar të datës 20.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 01.04.2025;

Përgjigjen në ankesë të datës 02.04.2025; Kërkesën e datës 03.02.2025 e parashtruar tek Kryesuesi i Komisionit të Ekspertëve; Organogramin e Zyrës së Kryeministrit; Vendimin me Nr. 02/67 të datës 26.02.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga provat e administruara rrjedhë së ankuesi sipas Vendimit me Nr. 02/67 të datës 26.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i është vazhduar mandati i Kryesuesit të Komitetit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike –KHAIA-së, në kohëzgjatje prej pesë (5) viteve.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 31.01.2025, ka parashtruar kërkesë për korrigjimin e ekuivalentimit të pagave tek Kryesuesi i Komisionit të Ekspertëve, pranë Zyrës së Kryeministrit, e pranuar nga ky i fundit më datë 03.02.2025, më ç’rast përmes kësaj kërkesë është kërkuar që të behët korrigjimi i ekuivalentimit të koeficientit për pozitën e Kryetarit të KHAIA-së, sipas shtojcës 14.4 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, si drejtues i lartë në fushën e aviacionit civil. Ndërsa, Komisioni i Ekspertëve më Vendimin Nr. 002/2025, të datës 21.02.2025, ka refuzuar kërkesën e ankuesit, me arsyetimin se KHAIA nuk është e themeluar si agjenci, sipas Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr. 002/2025 të datës 21.02.2025, të Komisionit të Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit, duke pretenduar së ky vendim është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, për faktin së pozita Kryesuesi i KHAIA është e nivelit të lartë drejtues dhe duhet të ri klasifikohet sipas koeficientit të ri si drejtues i lartë i aviacionit, sepse është Zyrtar kryesor administrativ i paraparë me nenin 31 paragrafi 31.2 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Kërkon që ankesa të aprovohet, të anulohet vendimi i kontestuar, të obligohet komisioni përkatës që të vendos koeficientin 16 dhe ta zbatoj Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Kolegji i Këshillit në kuptim të besueshmërisë së pretendimeve ankimore iu referua nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcakton se: “1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues dhe Sprovues të Kosovës; 1.2. anëtarët/ët e shërbimit të jashtëm; 1.3. zyrtarët/ët e Agjencisë së Aviacionit Civil dhe Agjencisë të Shërbimeve të Navigimit Ajror, që kryejnë shërbime operative në fushën e kontrollit dhe navigimit ajror; 1.4. **anëtarët/ët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike;**..... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t’i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin”, rrjedhimisht, mbi këtë bazë ligjor rrjedhë fakti i pa kontestueshëm së anëtarët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike kanë statusin e nëpunësit civil me status të veçantë.

Nisur nga pretendimi ankimor së pozita e kryesuesit të KHAIA është pozitë e lartë drejtuese, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, më theks të veçantë nenin 5 paragrafi 1, dhe nenin 31, e më të cilat dispozita është përcaktuar se: **Neni 5.1** : 1. Autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në Kosovë janë: a) Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit; b) Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës; c) Ministria e Punëve të Brendshme; **dhe d) Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike. Neni 31:** Komisioni për Hetimin

e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA) themelohet si njësi në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. 31.2 KHAIA nuk është organizatë e veçantë buxhetore. Kryesuesi i KHAIA shërben si zyrtari kryesor administrativ i KHAIA-s. Zyrtarët e tjerë financiar (zyrtari i prokurimit, zyrtari kryesor financiar dhe zyrtari i certifikimit) të KHAIA-s janë personat të cilët veçse i mbajnë këto pozita në Zyrën e Kryeministrit. Në të gjitha kuptimet tjera, veprimtaritë, hetimet dhe vendimmarrja e KHAIA ushtrohet në mënyrë të pavarur nga Qeveria dhe Zyra e Kryeministrit. Termi “Zyrtar Financiar” i përdorur në këtë nen, ka kuptimin e përkufizuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. 31.3 KHAIA është tërësisht e pavarur nga industria e aviacionit, AAC-ja, Ministria, Ministria e Punëve të Brendshme dhe autoritetet apo zyrtarët e tjerë publik. Pavarësisht nga fjalia e mësipërme, KHAIA duhet të përputhet me të gjitha aktet themelore juridike të cilat rregullojnë autoritetet publike dhe zyrtarët publik. KHAIA po ashtu do t’i nënshtrohet auditimit dhe hetimeve të tjera nga Ministria e Punëve të Brendshme, Auditori i Përgjithshëm dhe autoritetet e tjera publike, të cilat kanë për qëllim përcaktimin ose sigurimin e përputhshmërisë së KHAIA-së me këto akte themelore juridike. 31.4 KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ose ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë kudo qofshin ata. Kurdo që kërkohet ose është e nevojshme, KHAIA do të punojë në bashkëpunim me organet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat ushtrojnë funksione të njëjta. Kurdo që KHAIA kryen ose merr pjesë në një hetim të sipër cekur, KHAIA duhet të përgatisë një raport të hollësishëm lidhur me hetimin dhe t’ia dorëzojë këtë raport Qeverisë dhe Kuvendit sa më shpejtë që të jetë e mundur por jo më shumë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të hetimit. 31.5 KHAIA, sipas nevojës, do të përgatisë informata dhe të dhëna lidhur me sigurinë në fluturim, të cilat më pas i dorëzohen AAC-së, Qeverisë dhe Kuvendit. 31.6 KHAIA është e autorizuar që të kërkojë nga cilido autoritet publik i Kosovës dhe/ose person privat ose organizatë në Kosovë që t’i japë asaj përkrahjen e nevojshme për kryerjen e një hetimi të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni ose një hetimi i cili kërkohet sipas një marrëveshje ndërkombëtare ose organizate ndërkombëtare të aviacionit. 31.7 KHAIA përbëhet nga tre (3) persona fizik. Secili nga këta persona duhet që (i) të ketë njohuri të konsiderueshme të Gjuhës Angleze, (ii) të ketë përvojë të konsiderueshme teknike në industrinë e aviacionit, (iii) të mos jetë shpallur fajtor për vepër penale; (iv) të mos ketë interes, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, monetar, financiar, ose interes tjetër në një shoqëri tregtare e cila është e angazhuar në sektorin e aviacionit civil; dhe (v) është person me integritet të lartë moral dhe profesional. 31.8 Tre (3) anëtarët e KHAIA do të zgjidhen dhe emërohen nga Qeveria pas pranimi të rekomandimeve nga një panel i posaçëm (ad hoc) i cili përbëhet nga shërbyes të lartë civil dhe këshilltarë të emëruar nga Qeveria për identifikimin dhe rekomandimin e kandidatëve për anëtar të KHAIA. Ky panel do të miratojë dhe respektojë rregulla strikte për konfliktin e interesave të cilat, ndër tjera, e parandalojnë një anëtar të panelit nga votimi, pjesëmarrja ose ndikimi në procesin e zgjedhjes për një kandidat i cili është i njohur ose i cili është i lidhur me anëtarin përkatës të panelit (qoftë kjo përmes lidhjeve familjare, afariste, institucionale ose politike). 31.9 Të gjithë anëtarët e KHAIA emërohen, dhe duhet të pajtohen me shkrim se do të shërbejnë gjatë tërë kohëzgjatjes së mandatit, për një mandat prej pesë (5) viteve. Këta anëtarë mund të riemërohen për një ose më shumë mandate shtesë nëse ata/ato pajtohen me shkrim që të shërbejnë gjatë tërë kohëzgjatjes së mandatit. Qeveria do të caktojë njërin nga tre (3) anëtarët që të shërbejë si Kryesues i KHAIA. Kryesuesi është përgjegjës për përfaqësimin e KHAIA jashtë Qeverisë si dhe për organizimin dhe trimin e përditshëm të punëve administrative të KHAIA. Vendimet e KHAIA mbi ushtrimin e hetimeve si dhe përgatitja dhe miratimi i raporteve merren nga shumica e anëtarëve të KHAIA. 31.10 Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit duhet të sigurojë që KHAIA-së t’i sigurohet i tërë personeli sekretarial dhe administrativ të cilin KHAIA, në mënyrë të arsyeshme, e kërkon. Po ashtu, KHAIA mund të rekrutojë punësojë jo më shumë se tre (3) punonjës teknik dhe/ose profesional për t’i ndihmuar KHAIA-së në ushtrimin efektiv dhe efikas të funksioneve dhe përgjegjësi të cilat i janë dhënë KHAIA sipas këtij ligji. Rekrutimi i këtij personeli do të bëhet në bazë të meritës, kompetencës së dokumentuar dhe përvojës në fushën e aviacionit civil. ...

Ndërsa, sipas Rregullores Nr.16/2013 për Strukturën Organizative të Zyrës së Kryeministrit, si akt i zbatueshëm nga Zyra e Kryeministrit, gjegjësisht me nenin 3 pika 1.3, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike është paraparë si njësi administrative në kuadër të Kabinetit të Ministrit, ndërsa, me nenin 20 të kësaj rregullore është përcaktuar: *Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, në Zyrën Kryeministrit, është themeluar në bazë të Ligjit Nr. 03/L- 051 për Aviacionin Civil. KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ose ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë, kudo qofshin ata...3. Numri i të punësuarve në KHAIA është 3 (tre), njëri prej të cilëve është Kryesuesi i KHAIA-së, si në vijim: 3.1. Një (1) inspektor të operimeve; 3.2. Një (1) inspektor i inxhinierisë; 3.3. Një (1) inspektor incizues i fluturimeve,*

Për me tepër, duke u bazuar në neni 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku si pozita të kategorisë së lartë drejtuese janë përcaktuar: *sekretari i përgjithshëm, drejtori i përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtori ekzekutiv dhe zëvendësdrejtori në një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to, dhe nenin 11 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ku si pozita të kategorisë së lartë drejtuese janë paraparë: Drejtues i Lartë 1. Sekretar i Përgjithshëm në Zyrë të Kryeministrit; 2. Sekretar i Përgjithshëm në Ministri; 3. Drejtor i Përgjithshëm në Agjenci të Pavarura (apo pozitat ekuivalente); 4. Drejtor i Përgjithshëm në Agjencitë Rregullatore (apo pozitat ekuivalente). 5. Drejtor Ekzekutiv në Agjenci Ekzekutive (apo pozitat ekuivalente). 6. Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm në Agjenci të Pavarur dhe Rregullatore (apo pozitat ekuivalente). 7. Zëvendësdrejtor Ekzekutiv në një Agjenci Ekzekutive (apo pozitat ekuivalente), Kolegji i Këshillit mbi bazën e kuadrit ligjor të sipër theksuar erdhi në konstatimin së Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike është njësi organizative në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, që ushtron veprimtarinë sipas ligjit për aviacionin civil, dhe së i njëjti nuk ka statusin e agjencisë ekzekutive apo agjencisë së pavarur apo rregullatore, sepse edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike nuk është përcaktuar si institucion i administratës shtetërore dhe si pasojë e këtij konstatimi rrjedhë fakti së Kryesuesi i KHAIA nuk mund të cilësohet si zyrtar i lart drejtues.*

Bazuar në konstatimin si me lartë, Kolegji erdhi në përfundimin se akti i kundërshtuar më ankesë, gjegjësisht Vendimi Nr.002/2025, i datës 21.02.2025, i Komisionit të Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit, është nxjerr më vërtetim të drejt të gjendjes faktike dhe zbatim të drejt të ligjit material, mbi arsyet së në rastin konkret nuk mund të vie në zbatim shtojca 14.4 e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, konkretisht klasa B1, koeficienti 16, pasi që kjo klasë e pagës i referohet pozitave: *Drejtues/e i/e lartë në fushën e aviacionit civil dhe navigimit ajror; Drejtues/e i/e lartë profesional i kualifikuar që udhëheq një agjenci kyçe në fushën e sistemeve shtetërore të informacionit dhe komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore dhe pozitat e përcaktuara në akt nënligjor.* Rrjedhimisht, me të drejtë pozita e ankuesit për qëllime të pagës është kategorizuar në shtojcën 14.4, numër rendor 4, klasa B4 dhe koeficienti 14, ku i referohet pozitave: *Inspektor/Hetues në fushën e aviacionit civil/ushtarak dhe mbikëqyrës në fushën e navigimit ajror; Ekspert kyç i kualifikuar si zhvillues i lartë i aplikacioneve, ekspert i forenzikës së TI-së ose ekspert i lartë i sigurisë së infomacioneve/kibernetike për sistemet shtetërore të informacionit e komunikimit me rëndësi strategjike shtetërore dhe/ose komunikimeve elektronike dhe pozitat e përcaktuara në akt nënligjor,* sepse, siç u përshkrua më sipër, sipas Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe akteve tjera të lartpërmendura, KHAIA-ja është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion, kështu që edhe pozita e kryesuesit dhe anëtarit të KHAIA-së cilësohet si hetues, andaj, edhe pretendimi i ankuesit që të kategorizohet në Klasa B1 Koeficienti 16, është i pabazuar ligjërisht.

Marrë për bazë rrethanat dhe gjendjen e konstatuar si me lartë, vendimi i atakuar më ankesë është vendim i ligjshëm, i nxjerrë në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 22/2024 për Ekspertët, kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.543/2025**

**Avdyl BEKTESHI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Ardiana Azemi;
- Organit të punësimit: Komisionit të Ekspertëve në Zyrën e Kryeministrit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.